REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE,PROKURIMEVE DHE KONTRATAVE
SEKTORI JURIDIK DHE I PROKURIMEVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. 43, Date 06/05/2026

"PËR VIJIMIN E PROCEDURËS SË SHPRONËSIMIT TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 52, DATË 26.06.2020 "PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK , TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËVE VENDORE LAGJIA NR.2 DHE 3 DHE ZGJERIMI I RRUGËVE VENDORE AKS SUPERSTRADA E DEVOLLIT-ISMAIL QEMALI , DEMIR PROGRI, AKS RRUGA ETEM OSMAN XHAÇI" DHE MIRATIMI I VLERAVE PËR SUBJEKTET QË PREKEN NGA SHPRONËSIMI"

Bazuar në nenet 9 pika 1.2 germa b) dhe 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, në bazë të pikës 1 të nenit 5 dhe të pikës ç të nenit 8 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik, i ndryshuar dhe VKM nr. 89 datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë",

PROPOZOJ:

1. Vijimin e procedurës së shpronësimit të miratuar me vendimin nr. 52, datë 26.06.2020 "Për fillimin e procedurave për shpronësimin për interes publik , të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i rrugëve vendore lagjia nr.2 dhe 3 dhe zgjerimi i rrugëve vendore Aks Superstrada e Devollit-Ismail Qemali , Demir Progri, Aks Rruga Etem Osman Xhaçi".
2. Miratimin e vlerave sipas tabelës nr. 1 për subjektet që preken nga shpronësimi.
3. Për zbatimin e tij ngarkohet Komisioni i Shpronësimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve në nenin 55 të Ligjit Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

Konceptoi dhe konfirmoi bazen ligjore:
Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe i Prokurimeve
Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DEVOLL

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

Tabela nr. 1

- **Lista e pronarëve që shpronësohen për interes publik nga projekti "Rehabilitimi i rrugëve vendore lagjia nr.2 dhe 3 dhe zgjerimi i rrugeve vendore Aks Superstrada e Devollit, Ismail Qemali,Demir Progri; Aks Rruga Etem Esman Xhaci"**

Nr.	Nr. pasurie	Vol.	Faq.	Zk.	Emër Atësi Mbiemër	Lloji i Pasurisë	Sip. Totale (m2)	Arë (m2)	Truall (m2)	Ndërtesë (m2)	Sip. që shpronësohet (Truall)	Cmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)
1	1100/58	15	196	3804	Dëfrim Refik Çeliku	Arë+Truall	545		493	126.8	17	344	5848
2	5/552	19	226	1187	Aurel Bashkim Qerozi	Truall	280		280	63	14	2145	30030
3	1104/5	14	148	3804	Spiro Mihal Rushitaj	Truall	95		95		95	344	32680
4	1104/6	15	21	3804	Xhemali Fadil Skoti	Truall	639		639		355	344	122120
5	1104/7	15	22	3804	Qani Fadil Skoti	Truall	64		64		64	344	22016
6	5/606	22	122	1187	Vaid Safet Topalli	Truall	120		120		½ 120	2145	128700
7				1187	Eri Safet Gjiriti						½ 120	2145	128700
Shuma Totale (lekë)													**470,094**

Komisioni i Shpronësimit

Grupi i punës:

Eriksela Avdo

Tatjana Spaho

Aurela Furxhi

Manjola Hanelli

Erjon Rado

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE,PROKURIMEVE DHE KONTRATAVE
SEKTORI JURIDIK DHE PROKURIMEVE

Nr. 1626 **Prot** **Bilisht me,** 06.05 **/2026**

RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

"PËR VIJIMIN E PROCEDURËS SË SHPRONËSIMIT TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 52, DATË 26.06.2020 "PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK , TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËVE VENDORE LAGJIA NR.2 DHE 3 DHE ZGJERIMI I RRUGËVE VENDORE AKS SUPERSTRADA E DEVOLLIT-ISMAIL QEMALI , DEMIR PROGRI, AKS RRUGA ETEM OSMAN XHAÇI" DHE MIRATIMI I VLERAVE PËR SUBJEKTET QË PREKEN NGA SHPRONËSIMI."

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Devoll!

Bazuar në nenet 9 pika 1.2 germa b) dhe 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, në bazë të pikës 1 të nenit 5 dhe të pikës ç të nenit 8 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik, i ndryshuar dhe VKM nr. 89 datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërsië, po ju parashtrojmë relacionin si më poshtë vijon:

Bashkia Devoll ka filluar proçedurën pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim duke dërguar kërkesën për shpronësim për interes publik , të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimi I realizimit të projektit, "Rehabilitimi I rrugëve vendore lagjia nr. 2 dhe 3 dhe zgjerimi i rrugëve vendore Aks Superstrada e Devolli-Ismail Qemali,Demir Progri;Aks Rruga Etem Osman Xhaci".

Arsyeja që po e risjellim sërisht përpara Këshillit Bashkiak vazhdimin e procedurës së shpronësimit public të përcaktuar sipas Vendimit nr.52 datë 26.06.2020 "Për fillimin e procedurave për shpronësimin për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit "rehabilitimi i rrugëve vendore lagjia nr. 2 dhe 3 dhe zgjerimi i rrugëve vendore aks superstrada e Devollit-Ismail Qemali,Demir Progri;aks rruga Etem Osman Xhaci" lidhet me faktin se pas

depozitimit të dosjes të shpronësimit pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, kjo e fundit ka dërguar shkresë me numër 414/3 prot , datë 15.04.2026, protokolluar me tonën me numër 626/1, datë 20.04.2026 ku kërkon plotësim dokumentacioni për të vijuar me kërkesën për shpronësim ku ndër të tjera kërkon përditësimin e Vendimit nr.52 datë 26.06.2020 "Për fillimin e procedurave për shpronësimin për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit "rehabilitimi i rrugëve vendore lagjia nr. 2 dhe 3 dhe zgjerimi i rrugëve vendore aks superstrada e Devollit-Ismail Qemali,Demir Progri;aks rruga Etem Osman Xhaci" dhe miratimi i vlerave për subjektet që preken nga shpronësimi.

Deklarojmw se vlerat janw rillogaritur duke u referuar Vendimit nr. 89 datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë. Dhe se Vendimi nr.52 , datë 26.06.2020 "Për fillimin e procedurave për shpronësimin për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit "rehabilitimi i rrugëve vendore lagjia nr. 2 dhe 3 dhe zgjerimi i rrugëve vendore aks superstrada e Devollit-Ismail Qemali,Demir Progri;aks rruga Etem Osman Xhaci" nuk ka asnjë ndryshim dhe arsyeja përse po e sjellim sërish në këshill është për vazhdimin e procedurës së shpronësimit publik.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin!

Pergjegjes i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve
Eriksela Avdo

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com